



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 346, datë 09.09.2021**

**PËR**

**RICAKTIMIN E GJYQTARES SË SKEMËS SË DELEGIMIT ZNJ. {...},  
NË GJYKATËN E APELIT KORÇË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “ë” dhe nenin 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 45, pika 4, shkronja “a” dhe pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Korçë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} ricaktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 16.09.2022.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 16.09.2021.
3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Korçë.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së skemës së delegimit, znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**